



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.761/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-79658-07-18-2018 me objekt “Rikonstruksion + shtese anesore ne shkollen 9-vjecare fshati Shenepremte, Bashkia Divjake”, me fond limit 35 466 336 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 20.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Llazo”shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

“Shkëlqimi 07” shpk  
Fier, Qendër-Mallakastër, Belishovë, Fshati Belishovë, Rruga Nacionale Ballsh-Fier

“Llazo” shpk  
Autostrada Lushnjë-Fier, Pushimi i shoferit, Lushnjë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Divjake  
Lagjia nr. 2

**Subjekt i Interesuar:** “Jogi” shpk  
Lagjia 11 Janari, Fier

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,



*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërsa operatori ekonomik

“Llazo” shpk nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 18.07.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-79658-07-18-2018 me objekt “Rikonstruksion + shtese anesore ne shkollen 9-vjecare fshati Shenepremte, Bashkia Divjake”, me fond limit 35 466 336 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 20.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

II.2. Në datën 20.08.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Anbi	pa ofertë	I skualifikuar
- Zdravo	pa ofertë	I skualifikuar
- Colombo	pa ofertë	I skualifikuar
- Elda-VL	pa ofertë	I skualifikuar
- ED Konstruksion	pa ofertë	I skualifikuar
- Eni	22 896 371	I skualifikuar
- Shkëlqimi 07	25,000,000	I skualifikuar
- Llazo	26’315’984	I skualifikuar
- Avduli	26,537,991	I skualifikuar
- Spektri	26,974,124	I skualifikuar
- Jogi	28.185.600	I kualifikuar
- Mela	29,000,000	I skualifikuar
- B-93	29,114,814	I kualifikuar
- Aurora Konstruksion	29,743,270	I skualifikuar
- Xhimo&Kleo	31,033,770	I kualifikuar
- Hastoçi	33,366,525	I kualifikuar

II.4. Në datën 29.08.2018 operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- Nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për punëtorin e specializuar në ndërtim për: - pllakashtrues (2), bojaxhi (2) dhe suvatues (2), sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Nuk është paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuar për të provuar disponimin e mjetit Bobcat (cope 1) sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3 (i) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.

II.5. Në datën 04.09.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit, kriteri 2.3.h në DST kërkohet vetëm si më poshtë:

*h. Staf i teknik i shoqërisë të ketë në përbërje*

*Punëtori e specializuar në ndërtim*

*Pllakashtrues                      2 punonjës*

*Bojaxhi                                2 punonjës*

*Suvatues                                2 punonjës*

*Pra në DST autoriteti kontraktor nuk kërkon asnjë lloj dokumenti për të paraqitur dhe nuk përcakton asnjë organ lëshues i ndonjë dokumenti. Sa më sipër duke mos patur si kriter paraqitjen e ndonjë dokumenti KVO-ja nuk duhet të refuzonte ofertën tonë. Gjithsesi ne kemi paraqitur dokumenta provues se kemi të punësuar pllakashtrues 2, bojaxhi 2 dhe suvatues 2 të cilët janë në listpagesat e shoqërisë bashkëngjitur ofertës dhe kontrata individuale të punës respektive të ngarkuara në sistem. Vendimi për refuzimin e ofertës së Shkëlqimi 07 shpk është në kundërshtim me nenin 26 pika 5 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Refuzimi i KVO-së është i paarsyetuar dhe i pambështetur në kriteret e vendosura dhe në bazën ligjore përkatëse.*

- Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se kemi të bëjmë me një mjet gjermues /ngarkues të vogël të quajtur ndryshe dhe em termat Miniskrep, Minieskavator apo Minifadrom. Së pari sqarojmë se cilësimi në kriterin e vendosur të mjetit me emërtimin Bobcat vjen në kundërshtim me LPP si dhe rregullat e dala për interpretim pasi është një Brand Name, emër marke e një minigjermuesi, produkt i vetëm i një prodhuesi të mjeteve të ndërtimit amerikan Bobcat Company.

*Për plotësimin e këtij kriteri në ofertën tonë ne kemi paraqitur 5 mjete të tilla pra perfishin e kërkuar në kriter si më poshtë:*

*Minieskavator Caterpillar 303 5 Shkëlqimi 07*

*Minieskavator Kubota U25 Shkëlqimi 07*

*Minieskavator Shkëlqimi 07 shpk 1*

*Minieskavator Zinxhir Gome Ēakker Shkëlqimi 07*

*Miniskrep Kubota Shkëlqimi 07*

*Mendojmë se vendimi i marrë nga KVO është i padrejtë , i pambështetur në llogjikën e prokurimit dhe nuk qëndron.*

*Sa më sipër kërkojmë rivlerësim dhe kualifikimin e operatorit ekoomik Shkëlqimi 07 shpk dhe shpalljen e tij fitues.*

II.6. Në datën 13.09.2018 me anë të shkresës nr.2863/1 prot datë 10.09.2018 ankimuesi është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 20.09.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 29.08.2018 operatori ekonomik “Llazo” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Dokumentacioni i paraqitur nga shoqeria “LLAZO” sh.p.k per plotesimin e kriterit “pune e ngjashme” nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit. Ne dokumentacionin e paraqitur nga kjo shoqeri per permbushjen e ketij kriteri, ka shume zera te preventivit te cilat nuk perputhen me preventivin object prokurimi. Kjo vjen ne kundersiztim me piken 2.3(f) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.*
- *Ne kontraten e bashkepunimit, per bashkimin e perkohshem te dy shoqerive “LLAZO” sh.p.k dhe “ALUERA” sh.p.k, eshte shenuar gabim fondi limit per kete procedure prokurimi.*
- *Per inxhinierin elektrik, pjese e stafit teknik te “LLAZO” sh.p.k nuk eshte paraqitur licenca dhe librezja e punes. Kjo vjen ne kundersiztim me piken 2.3(h) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.*
- *Nuk eshte paraqitur dokumentacioni i kerkuar per punetori te specializuar ne ndertim per: - saldator (1), sic eshte kerkuar ne DST. Kjo vjen ne kundersiztim me piken 2.3(h) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.*

II.9. Në datën 04.09.2018 operatori ekonomik “Llazo” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton skualifikimin e ofertës së tij.

II.10. Në datën 13.09.2018, me shkresën nr.2865/1 datë 10.09.2018 prot, operatori ekonomik “Llazo” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.11. Në datën 21.09.2018 pala ankimuese “Llazo” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Njëpërmjet shkresës nr.3192 prot datë 02.10.2018 protokolluar me tonën me nr.1515/2 datë 03.10.2018 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shkëlqimi 07” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “Nuk është paraqitur dokumentacioni i kerkuar për punetori të specializuar në ndërtim për: - pllakashtrues (2), bojaxhi (2) dhe suvatues (2), sic është kerkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me piken 2.3(h) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3/h “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:*

- Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Topograf 1 (një)
- Arkitekt 1 (nje)

- *Mjek* 1 (një)
- Teknik ndërtimi* 2 (dy)
- Punëtori e specializuar me makineri, manovratorë* 2 punonjës
- Punëtori e specializuar në ndërtim*

*Elektricist* 2 punonjës

*Hidraulik* 2 punonjës

*Murator* 2 punonjës

*Pllakashtrues* 2 punonjës

*Bojaxhi* 2 punonjës

*Suvatues* 2 punonjës

*Saldator* 2 punonjës

*Mekanik* 2 punonjës

*Karpentier* 2 punonjës

- ✓ *Punonjes te pajisur me deshmi profesionale ose leje manovrimi* 5 punonjës

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Shkëlqimi 07” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune datë 04.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Shkëlqimi 07 shpk dhe R.D në pozicionin elektrikist/meremetues/bojaxhi
- Kontratë Pune datë 04.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Shkëlqimi 07 shpk dhe G.D në pozicionin elektrikist/meremetues/bojaxhi.
- Kontratë Pune datë 04.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Shkëlqimi 07 shpk dhe A.G në pozicionin elektrikist/meremetues/bojaxhi
- Kontratë Pune datë 04.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Shkëlqimi 07 shpk dhe A.Q në pozicionin Elektricitist/Pllakashtrues/Meremetues.
- Kontratë Pune datë 04.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Shkëlqimi 07 shpk dhe V.L në pozicionin Manovrator/Pllakashtrues
- Kontratë Pune datë 04.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Shkëlqimi 07 shpk dhe F.L në pozicionin Murator/Karpentier/Suvatues/Meremetues

- Kontratë Pune datë 04.01.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Shkëlqimi 07 shpk dhe F.I në pozicionin Murator/Suvatues/Karpentier

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]*”

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*”

III.1.4. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2.*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

III.1.5. Në nenin 26, pika 5 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*”

Ndërsa po këtu, pika 8, përcaktohet: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit



me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se është kërkuar shprehimisht që stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje ndër të tjera edhe *pllakashtrues (2), bojaxhi (2) dhe suvatues (2)*. KPP konstaton se në kriter nuk është kërkuar/specifikuar asnjë dokument konkret i cili të paraqitet në përmbushje të këtij kriteri për të provuar disponueshmërinë e stafit teknik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk rezulton se janë paraqitur kontrata pune për specialitetet e lartpërmendura.

KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë se nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në kushtet kur ky i fundit nuk ka përcaktuar asnjë dokument konkret për tu dorëzuar. Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë përmbushjen e kriterëve vetëm për atë që ka kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter apo specifikim tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “*Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese*” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shkëlqimi 07” sh.p.k., për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi me

arsyetimin se “Nuk eshte paraqitur asnje nga dokumentat e kerkuar per te provuar disponimin e mjetit Bobcat (cope 1) sic eshte kerkuar ne DST. Kjo vjen ne kundërshtim me piken 2.3 (i) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 12, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3./i “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- i. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës; të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe **libreza teknike**) për :

<i>Fadrome me gome</i>	<i>cope 2</i>
<i>Kamion me kapacitet me te madh se 15 ton</i>	<i>cope 2</i>
<i>Kamioncina</i>	<i>cope 3</i>
<i>Kamion me vinc</i>	<i>cope 1</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>cope 2</i>
<i>Autopompe betoni</i>	<i>cope 1</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>cope 1</i>
<i>Skela</i>	<i>1500 m</i>
<i>Gjenerator</i>	<i>cope 2</i>
<i>Kompresor</i>	<i>cope 2</i>
<i>Bobcat</i>	<i>cope 1</i>
<i>Motosaldatrice</i>	<i>cope 2</i>
<i>Pompe Suvatimi</i>	<i>cope 1</i>



III.2.2. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se

*zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]*”

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.2.3. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.2.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimes “Shkëlqimi 07” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë Doganore për mjetin Minieskavator i përdorur Caterpillar datë 27.11.2017
- Deklaratë Doganore datë 18.11.2011 me përshkrim Miniskrep i përdorur copë 1, foto të mjetit.
- Deklaratë Doganore datë 02.03.2018 me përshkrim Minieskavator me zinxhir gome
- Deklaratë Doganore datë 07.09.2010 me përshkrim Minieskavator viti 2008 me zinxhir gome, foto të mjetit
- Deklaratë Doganore datë 28.10.2017 me përshkrim Minieskavator i përdorur , Kubota Viti 2014, foto të mjetit
- Deklaratë Doganore datë 27.11.2017 me përshkrim Minieskavator i përdorur , Katerpillar, Viti 2005 copë 1, foto të mjetit

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përfitojnë në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

III.2.6. Marrë shkas nga emërtimi Bobcat (i përdorur nga autoriteti kontraktor në procedurën e prokurimit objekt ankimi) KPP nga një kërkim i thjeshtë në internet konstatoi se ky emër i referohej një prodhuesi, konkretisht "Bobcat Company". Në faqen zyrtare të kësaj kompanie rezulton se termi Bobcat i referohet një mjeti i cili në Republikën e Shqipërisë njihet ndryshe me termin minieskavator. Referuar sa më sipër KPP e gjen të drejtë pretendimin e ankimuesit se emërtimi Bobcat është një emër marke. Një emërtim i tillë nuk rezulton të përdoret në Kodin Rugor të Republikës së Shqipërisë dhe as në aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij. KPP gjen me vend të tërheqë vëmendjen e autoritetit kontraktor lidhur me përdorimin e emrit Bobcat në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike duhet të shmangë emërtimin e çfardolloj brendi apo marke pasi kjo bie ndesh me dispozitat ligjore të përcaktuara në LPP.

Në këto kushte KPP pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga ankimuesi lidhur me disponimin nga ana e tij të një minieskavatori konstatoi se janë paraqitur disa deklaratat doganore me përshkrim minieskavatorë dhe foto të mjetit. KPP gjykon se dokumentacioni i dorëzuar nga ankimuesi dëshmon se ai disponon në pronësi të tij, disa minieskavatorë pra më shumë minieskavatorë se sa numri i kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit. KPP gjykon se pretendimi i autoritetit kontraktor se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuar për të provuar disponimin e mjetit Bobcat (cope 1) sic është kërkuar në DST nuk rezulton i drejtë, pasi ankimuesi ka paraqitur një dokument që vërteton pronësinë e mjetit (deklaratë doganore) në përputhje me kriterin kualifikues të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Llazo" shpik përkundërshtimin e kualifikimit të ofertës së tij KPP vëren se,

III.3.1. Në datën 29.08.2018 operatori ekonomik “Llazo” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “LLAZO” sh.p.k per plotesimin e kriterit “pune e ngjashme” nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit. Ne dokumentacionin e paraqitur nga kjo shoqëri per permbushjen e ketij kriteri, ka shume zera te preventivit te cilat nuk perputhen me preventivin object prokurimi. Kjo vjen ne kundërshtim me pikën 2.3(f) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.*
- *Ne kontraten e bashkepunimit, per bashkimin e perkohshem te dy shoqërive “LLAZO” sh.p.k dhe “ALUERA” sh.p.k, eshte shenuar gabim fondi limit per kete procedure prokurimi.*
- *Per inxhinierin elektrik, pjese e stafit teknik te “LLAZO” sh.p.k nuk eshte paraqitur licenca dhe librezë e punes. Kjo vjen ne kundërshtim me pikën 2.3(h) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.*
- *Nuk eshte paraqitur dokumentacioni i kerkuar per punetori te specializuar ne ndertim per: - saldator (1), sic eshte kerkuar ne DST. Kjo vjen ne kundërshtim me pikën 2.3(h) “kapaciteti teknik”, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.*

III.3.2. Në datën 04.09.2018 operatori ekonomik “Llazo” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton skualifikimin e ofertës së tij.

III.3.3. Në datën 13.09.2018, me shkresën nr.2865/1 datë 10.09.2018 prot, operatori ekonomik “Llazo” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

III.3.4 Në datën 21.09.2018 pala ankimuese “Llazo” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën

5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit rezulton se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 04.09.2018 fakt i cili provohet edhe nga informacioni i autoritetit kontraktor si dhe nga shkresa kthim përgjigje nr. 2865/1 prot datë 10.09.2018 drejtuar ankimesit nga autoriteti kontraktor. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar” *strictu sensu* parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor . Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka ezauaruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve nga dita e marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. Sa më sipër, K.P.P. konstaton se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 21.09.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë.

III.3.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik Llazo shpk pranë K.P.P. nuk ka respektuar afatet e ankimit, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.3.8. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimesit, ankimit nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-79658-07-18-2018 me objekt “*Rikonstruktion + shtese anesore ne shkollen 9-vjecare fshati Shenepremte, Bashkia Divjake*”, me fond limit 35 466 336 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 20.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Llazo” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1515 Protokoll; Datë 20.09.2018**

**Nr.1522 Protokoll; Datë 21.09.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**